



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**  
**K.P.P. 622/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.09.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

**Objekt:**

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-40008-01-10-2018, me objekt “Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike të Objekteve dhe Godinave, Sipërfaqeve të Gjelbërta dhe Bimësisë, të QSUT” – Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 69.005.544,30 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 16.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

**Ankimues:**

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k.  
Rruga “Sulejman Pasha” sh.p.k., Pallati i ri 9 Katësh, kati përdhe, pranë Gjimnazit “Sinan Tafaj”, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë  
Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 11.01.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-40008-01-10-2018, me objekt “Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike të Objekteve dhe Godinave, Sipërfaqeve të Gjelbërta dhe Bimësisë, të QSUT” – Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 69.005.544,30 lekë (pa

TVSH), zhvilluar në datë 16.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

II.2. Në datën 16.03.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 23.03.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |   |                                   |
|---|-----------------------------------|
| 1. BO “A 2000” sh.p.k. & “Mandi 2K” sh.p.k.   | 55.988.149,35 lekë, skualifikuar  |
| 2. BO “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k.   | 61.235.378,4 lekë, kualifikuar    |
| 3. “Nazeri 2000” sh.p.k.  | 61.235.378.4 lekë, kualifikuar    |
| 4. “Oktapus” sh.p.k.  | 61.235.378.4 lekë, kualifikuar    |
| 5. “Aulona Pol 1” sh.p.k.   | 61.235.378.4 lekë, skualifikuar   |
| 6. “Global Security” sh.p.k.  | 61.235.378.4 lekë, skualifikuar   |
| 7. “International Security Albania” sh.p.k.   | 61.235.378.4 lekë, skualifikuar   |
| 8. BO “S.S.X” sh.p.k. & “Cullhaj” sh.p.k.   | 61.235.378.4 lekë, skualifikuar   |
| 9. “Oktapus 1 Security” sh.p.k.   | 61.235.378.4 lekë, skualifikuar   |
| 10. BO “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. | 61.235.378.4 lekë, skualifikuar   |
| 11. “Leksi Security” sh.p.k.  | 61.247.872.35 lekë, skualifikuar  |
| 12. “Pelicani Security” sh.p.k.   | 61.247.872.35 lekë, skualifikuar  |
| 13. “Arbana” sh.a.  | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.4. Gjithashtu nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, konstatohet se në datën 06.04.2018, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, si më poshtë vijon:

- |   |                                   |
|---|-----------------------------------|
| 1. BO “A 2000” sh.p.k. & “Mandi 2K” sh.p.k.   | 55.988.149,35 lekë, skualifikuar  |
| 2. BO “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k.   | 61.235.378,4 lekë, kualifikuar    |
| 3. “Nazeri 2000” sh.p.k.  | 61.235.378.4 lekë, kualifikuar    |
| 4. “Oktapus” sh.p.k.  | 61.235.378.4 lekë, kualifikuar    |
| 5. “Aulona Pol 1” sh.p.k.   | 61.235.378.4 lekë, kualifikuar    |
| 6. “Global Security” sh.p.k.  | 61.235.378.4 lekë, kualifikuar    |
| 7. “International Security Albania” sh.p.k.   | 61.235.378.4 lekë, kualifikuar    |
| 8. BO “S.S.X” sh.p.k. & “Cullhaj” sh.p.k.   | 61.235.378.4 lekë, kualifikuar    |
| 9. “Oktapus 1 Security” sh.p.k.   | 61.235.378.4 lekë, skualifikuar   |
| 10. BO “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. | 61.235.378.4 lekë, skualifikuar   |
| 11. “Leksi Security” sh.p.k.  | 61.247.872.35 lekë, skualifikuar  |
| 12. “Pelicani Security” sh.p.k.   | 61.247.872.35 lekë, skualifikuar  |
| 13. “Arbana” sh.a.  | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.5. Në datën 14.06.2018, Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. &

“Eurogjici-Security” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k. dhe operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k., në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, mori vendimin K.P.P. 412/2018, datë 14.06.2018, ku vendosi si më poshtë vijon:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-40008-01-10-2018, me objekt “Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike të Objekteve dhe Godinave, Sipërfaqeve të Gjelbërta dhe Bimësisë, të QSUT” – Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 69.005.544,30 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 16.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.
2. Të pranojë ankesat nr. 734 prot., datë 11.04.2018 dhe nr. 779 prot., datë 18.04.2018 të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. dhe “Myrto Security” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të mos pranojë ankesat nr.735 prot., datë 11.04.2018 dhe nr.793 prot., datë 20.04.2018 të paraqitura nga operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. si dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Oktapus” sh.p.k., “Nazeri 2000” sh.p.k., “Global Security” sh.p.k., “International Security Albania” sh.p.k., “Aulona Pol 1” sh.p.k. dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “S.S.X” sh.p.k. & “Cullhaj” sh.p.k. si dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
6. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
8. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k.
9. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. dhe “Myrto Security” sh.p.k., për ankesën nr.734 prot., datë 11.04.2018 dhe ankesën nr. 779 prot., datë 18.04.2018.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.6. Në datën 02.07.2018, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik K.P.P. 412/2018, datë 14.06.2018, si më poshtë vijon:

1. BO“A 2000” sh.p.k. & “Mandi 2K” sh.p.k. 55.988.149,35 lekë, skualifikuar

2. BO "Flena RB" sh.p.k. & "Myrto Security" sh.p.k.	61.235.378,4	lekë, kualifikuar
3. "Nazeri 2000" sh.p.k.	61.235.378.4	lekë, skualifikuar
4. "Oktapus" sh.p.k.	61.235.378.4	lekë, skualifikuar
5. "Aulona Pol 1" sh.p.k.	61.235.378.4	lekë, skualifikuar
6. "Global Security" sh.p.k.	61.235.378.4	lekë, skualifikuar
7. "International Security Albania" sh.p.k.	61.235.378.4	lekë, skualifikuar
8. BO "S.S.X" sh.p.k. & "Cullhaj" sh.p.k.	61.235.378.4	lekë, skualifikuar
9. "Oktapus 1 Security" sh.p.k.	61.235.378.4	lekë, skualifikuar
10. BO "Toni Security" sh.p.k. & "N.S.S (Ndreu Security Services)" sh.p.k. & "Eurogjici-Security" sh.p.k.	61.235.378.4	lekë, kualifikuar
11. "Leksi Security" sh.p.k.	61.247.872.35	lekë, skualifikuar
12. "Pelicani Security" sh.p.k.	61.247.872.35	lekë, skualifikuar
13. "Arbana" sh.a.		Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues "Flena RB" sh.p.k. & "Myrto Security" sh.p.k. në datën 05.07.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke ngritur pretendime mbi rivlerësimin e datës 02.07.2018, konkretisht duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë "Toni Security" sh.p.k. & "N.S.S (Ndreu Security Services)" sh.p.k. & "Eurogjici-Security" sh.p.k. me pretendimet si më poshtë vijon:

[...] 1-Në pikën 2 të nenit 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", përcaktohet se: "Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi." Referuar dispozitës së sipërcituar kërkohet që ndarja konkrete e shërbimeve që do të kryhet nga cdo anëtar i bashkimit bëhet që në momentin e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe pasqyrohet në kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomikë, duke i dhënë në këtë mënyrë autoritetit kontraktor gjithë informacionin e nevojshëm në bazë të të cilit do të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga secili anëtar i BOE në ofertë. Në kundërshtim me këtë dispozitë, BOE në kontratën e bashkimit nuk kanë përcaktuar elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, konkretisht numrin e rojeve me të cilët do të jetë pjesëmarrës cdo anëtar i BOE, venrojet ku do të kryhet shërbimi nga secili prej anëtarëve të BOE. Gjithashtu BOE nuk e ka pasqyruar këtë bashkim në sistemin elektronik të prokurimeve app, ku në llogarinë e kryesuesit të BOE pasqyrohen/selektohen edhe anëtarët e tjerë të BOE, konkretisht anëtari "Eurogjici Security" dhe "NSS", kërkesë kjo e përcaktuar në udhëzimet dhe manualët për operatorët ekonomikë. Për sa më sipër oferta e BOE duhet të refuzohet/skualifikohet.

2- Në shtojcën 7, pika 2, "Kriteret e Vecanta për Kualifikim", germa dh, është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin formularin e informacionit konfidencial. Formular i cili asnjë nga anëtarët e bashkimit nuk e ka paraqitur, në kundërshtim me nenin 16 të VKM nr.914.

3- Në shtojcën 7, "Për kapacitetin ligjor/profesional" pika 3, është përcaktuar kriteri, citoj: "- Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën \_63\_ punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë; përfshire titullarin dhe drejtuesin teknik të shoqërisë.

- Vertetim i lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore , i cili duhet të përmbajë të dhëna për listen emerore të punonjesve të shërbimit të certifikuar dhe vlefshmerinë e këtyre certifikatave – datën e certifikimit ( datën e lëshimit) , si edhe afatin e vlefshmerisë së kësaj certifikate.” Ndërsa në pikën 6/a “Kapaciteti teknik”, përcaktohet se “Operatori ekonomik duhet të ketë qendër kontrolli funksionale të miratuar nga Policia e Shtetit si : a. jo më pak se 63 punonjes shërbimi (me certifikatat perkatese dhe listen emerore)”. Në ligjin 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 5 “Certifikimi”, pika 2 dhe pika 5, përcaktohet [...]. referuar dispozitave dhe kriterit të sipërcituar, që oferta e BOE “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. të konsiderohet e vlefshme duhet: a) që ti provojë autoriteti kontraktor se ka të licensuar (certifikuar) pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë minimalisht 63 punonjës shërbimi, nënkategoria 1.3.A, duke paraqitur Certifikatat për Punonjës Shërbimi lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë për të paktën 63 punonjës shërbimi. b) certifikatat për punonjës shërbimi lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, të paktën 63 punonjës të paraqitura nga ky operator si pjesë e ofertës, që të konsiderohen të vlefshme duhet të jenë të vlefshme sipas përcaktimeve të dispozitave të sipërcituara, duhet të jenë të lëshuara brenda afatit 4 vjeçar, pra të jenë të lëshuara jo më parë se datë 16.03.2014 (data e dorëzimit të ofertave). Pra referuar dispozitave të sipërcituara certifikatat e punonjesve të shërbimit të cilave u ka kaluar afati 4 vjeçar janë të pavlefshme. BOE “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. nuk kanë paraqitur certifikatat e punonjesve të shërbimit brenda afatit 4 vjeçar të vlefshmërisë, për rrjedhojë certifikatat e paraqitura sipas përcaktimeve të dispozitave të sipërcituara janë të pavlefshme dhe nuk plotësojnë kriterin e sipërcituar. Ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm si nga vetë certifikatat e paraqitura edhe nga lista emërore e vertetimit (te performancës) lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Tiranë për 3 anëtarët e BOE në të cilët jepet informacion për numrin dhe datën e lëshimit të certifikatave. Sa më sipër BOE nuk plotëson këtë kriter ndaj oferta e tij duhet të refuzohet/skualifikohet.

4- Në pikën 3 të nenit 74 të VKM nr.914 [...], sipas kësaj dispozite që oferta e BOE të konsiderohet e vlefshme cdo anëtar i BOE duhet të plotësojë kriteret kualifikuese, e konkretisht, kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike...në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në shërbim. Në shtojcën 7, “Për kapacitetin ligjor/profesional” pika 3, është përcaktuar kriteri, citoj: “-Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën \_63\_ punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë; përfshire titullarin dhe drejtuesin teknik të shoqërisë. - Vertetim i lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore , i cili duhet të përmbajë të dhëna për listen emerore të punonjesve të shërbimit të certifikuar dhe vlefshmerinë e këtyre certifikatave – datën e certifikimit ( datën e lëshimit) , si edhe afatin e vlefshmerisë së kësaj certifikate.” Ndërsa në pikën 6/a “Kapaciteti teknik”, përcaktohet se “Operatori ekonomik duhet të ketë qendër kontrolli funksionale të miratuar nga Policia e Shtetit si : a. jo më pak se 63 punonjes shërbimi (me certifikatat perkatese dhe listen emerore)”. Referuar dispozitës dhe kriterëve të sipërcituara, që oferta e BOE të konsiderohet e vlefshme duhet që certifikatat e punonjesve të shërbimit të lëshuara brenda afatit 4 vjeçar të paraqitura nga cdo anëtar i bashkimit të korrespondojnë me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim, të përcaktuar nga BOE në kontratën/akt marrëveshjen e BOE të paraqitur në ofertë. Numri i certifikatave të punonjesve të shërbimit të lëshuara të cilat plotësojnë kushtin e vlefshmërisë së tyre (brenda afatit 4 vjeçar) paraqitura nga BOE në ofertë nuk

korrespondon me përqindjen e pjesëmarrjes në shërbim të cdo anëtari të BOE. Ky fakt provohet nga certifikatat e punonjësve të shërbimit të paraqitura në ofertë, vërtetimet e performancës dhe lista emerore bashkëngjitur tyre lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë dhe kontratat/aktmarrëveshja e BOE. Kjo passjell mosplotësim të pikës 3 dhe 6 të Shtojcës 7 të sipërcituar, ndaj oferta e BOE duhet të refuzohet/skualifikohet.

5- Në pikën 6/c "Kapaciteti teknik", përcaktohet se: "6. Operatori ekonomik duhet të ketë qendër kontrolli funksionale të miratuar nga Policia e Shtetit si : c. Nuk ka mase administrative gjatë vitit të fundit. \*Per sa me lart te provohen me paraqitjen e vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë." Që oferta e BOE, të konsiderohet e vlefshme, në përmbushje të këtij kriteri duhet që asnjë prej anëtarëve të BOE të mos kishte masa administrative gjatë vitit të fundit. Sic rezulton nga Vërtetimet e performancës lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë të paraqitura në ofertë, anëtarët e BOE kanë marrë masa administrative në emer të operatorit ekonomik (subjektit), ndaj për mospërmbushje të këtij kriteri, oferta e BOE duhet të refuzohet/skualifikohet.

6- Në shtojcën 7, "Kapaciteti teknik", pika 1, është përcaktuar kriteri: "Shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të marra së bashku, në një vlerë sa 40 % të fondit limit. -Kur shërbimi i ngjashëm është i realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e realizimit të lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate. ose -Në rastin e përvijës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara." Në përmbushje të këtij kriteri operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rastin konkret anëtarët e BOE së bashku dhe vec e vec, kanë detyrimin të provojnë autoritetit kontraktor, se kanë realizuar sukseshëm shërbime të ngjashme brenda 3 viteve të fundit, periudhës 16.03.2015 – 16.03.2018. Kontratat e ngjashme të realizuara nga 3 anëtarët e BOE të paraqitura në ofertë nuk janë brenda periudhës 16.03.2015 – 16.03.2018, ndaj për këtë mospërmbushje, BOE duhet të refuzohet/skualifikohet.

7- Në shtojcën 7, "Kapaciteti teknik" pika 8 është përcaktuar kriteri: "Subjektet e SHPSF-së duhet të provojnë se, disponojnë mjete dhe pajisje teknike për të përmbushur objektin e kësaj kontrate si më poshtë:

Nr.	Emertimi i pajisjeve	Sasia	Disponibiliteti
1.	Radio nderlidhje	21 cope	ne pronesi ose me qera
2.	Automjete	2 cope	ne pronesi ose me qera

- i. Për pajisjet, nëse janë në pronësi, duhet të paraqitet fatura tatimore e shitjes.
- ii. Për pajisjen, nëse është me qera, duhet të paraqitet kontrata e qirasë dhe fatura tatimore e shitjes.
- iii. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (certifikata e pronësise, leje qarkullimi, police sigurimi dhe kontrolli teknik).
- iv. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qirase si dhe dokumenti që vërteton regjistrimin (certifikata e pronësise, leje qarkullimi, police sigurimi dhe kontrolli teknik)."

Në përmbushje të këtij kriteri, që oferta e BOE të konsiderohet e vlefshme duhet ti provonin autoritetit kontraktor se disponojnë (në pronësi ose me qira) të gjithë sëbashku dhe vec e vec, në raport me pjesëmarrjen në punë, 21 radio ndërlidhje, konform sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 74 të VKM 914. Anëtarët e BOE nuk e kanë plotësuar këtë kriter sipas përqindjes së pjesëmarrjes në BOE. Pra radio ndërlidhjet që ka paraqitur nuk korrespondojnë me pjesëmarrjen në shërbim të përcaktuar në kontratë, ndaj oferta e tyre duhet të refuzohet/skualifikohet.

8. Në dokumentat e tenderit bashkengjitur shtojcës I “Formulari i ofertës”, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar:

Sqarime:

1. Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiper, duke pasqyruar te gjitha koston per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.
- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e koston në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek ( e kërkuar ne dokumentat e tenderit

Nga sa cituam mesiper cdo operator ka detyrimin qe te plotesoje te gjitha rubrikat dhe zerat e preventivit si me poshte:

1. Shpenzime per page baze: per 1 roje ne dite



2. Shpenzime per page baze: per 1 vendroje ne dite
3. Shtese mbi page per turnin II: per 1 roje ne dite
4. Shtese mbi page per turnin II: per 1 vendroje ne dite
5. Shtese mbi page per turnin III: per 1 roje ne dite
6. Shtese mbi page per turnin III: per 1 vendroje ne dite
7. Shpenzime per sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%: per 1 roje ne dite
8. Shpenzime per sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%: per 1 vendroje ne dite
9. Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite
10. Vlera totale pa tvsh per 1 vendroje ne dite
11. Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite
12. Vlera totale me tvsh per 1 vendroje ne dite

*Pra plotesimi i preventivit (analiza e kostos) sipas kerkeses se mesiperme eshte kusht kualifikues sipas Shtojces 7, pika 3.3 "Kapaciteti Teknik" nenpika 5. Ne kundershtrim me kete kriter BOE nuk ka plotesuar me cmime zerat e prevetivit per 1 vendroje ne muaj, si me poshte:*

1. Shpenzime per page baze: per 1 vendroje ne dite
2. Shtese mbi page per turnin II: per 1 vendroje ne dite
3. Shtese mbi page per turnin III: per 1 vendroje ne dite
4. Shpenzime per sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%: per 1 vendroje ne dite

*Kjo mos permbushje perben shkak per skualifikimin e "Toni Security" sh.p.k. & "N.S.S (Ndreu Security Services)" sh.p.k. & "Eurogjici-Security" sh.p.k. pasi nuk ka permbushur nenpiken 5 te sipercituar.*

*9. Bashke me dokumentat e tenderit është miratuar edhe shtojca 1 "Formulari I ofertës" si më poshtë:*

**Shtojca 1**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik ]

**FORMULARI I OFERTËS**  
**Public Health Sector**

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

\* \* \*

*Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]*

*Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ objekti]*

*Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se*

\* \* \*

*Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:*

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3		4	5
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njësi /dite	Afati i perlllogaritur ne dite
1.	Sherbimi i ruajtjes se godines se	dite	1		

	_____ per 1 vend roje me 3 turne				
	Çmimi Neto				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Operatorët pjesëmarrës në një procedurë prokurimi kanë detyrimin e paraqitjes së ofertave financiare, duke plotësuar pas asnjë ndryshim Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”. Pra kanë detyrimin e plotësimit të të gjitha rubrikave të këtij formulari, e konkretisht: 1. Emrin e operatorit ekonomik; 2. Emrin e autoritetit kontraktor që i drejtohet oferta; 3. LLojin e procedurës së prokurimit; 4. Përshkrimin e shkurtër të objektit të kontratës; 5. Vlerën totale të ofertës pa tvsh; 6. Vlerën totale të ofertës me tvsh. Gjithashtu kanë detyrimin e plotësimit të të gjitha rubrikave të përcaktuara në tabelën ku llogaritet vlera e kontratës, e që janë: 1. Cmimi për njësi/ditë për 1 vendroje; 2. Afatin e përlllogaritur në ditë; 3. Cmimin neto; 4. Tvsh (%); 5. Cmimi total. Ju sjellim në vëmendje se në dokumentat e tenderit, “Njoftimi I Kontratës”, pika 2.2 është përcaktuar:

Fondi i Marrveshjes Kuader per 12 muaj- 69,005,544.3 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e pesë mijë e pesëqind e dyzet e katër pikë tre) LEKE pa TVSH

Fondi limit per nje vendroje/DITORE- 9,002.68 (nëntë mijë e dy pikë gjashtëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH

Pra fondi limit i kësaj procedure prokurimi është deklaruar në vlerë totale për periudhën 12 mujore (69,005,544.3 lekë pa tvsh) dhe fond ditor për 1 vendroje (9,002.68 lekë pa tvsh). Neni 17 i VKM 914 përcakton, citoj “Oferta ekonomike përmban vlerën e ofertës. Kësaj oferte i bashkëlidhet një listë e hollësishme cmimesh”. Sipas kësaj dispozite vlera totale e ofertës është shumatorja e cmimit për njësi, e që përlllogaritet nga shumëzimi i cmimit për njësi me sasinë e shërbimeve që ofrohen dhe afatin e shërbimit që kërkohet të ofrohet. Kjo sanksionohet nga pika 2.3 e “Udhëzime për operatorët ekonomik” në dokumentat e tenderit në të cilën përcaktohet, citoj: “Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të ofertës të të gjitha Shërbimeve, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës”. Referuar dispozitave të sipërcituara BOE nuk e ka paraqitur formularin e ofertës sipas kërkesave të sipërcituara pasi: 1. Nuk e ka përcaktuar vlerën totale të ofertës pa Tvsh. 2. Nuk e ka përcaktuar vlerën totale të ofertës me Tvsh. Gjithashtu në tabelën ku llogaritet vlera e kontratës: 1. Nuk ka përcaktuar afatin e përlllogaritur në ditë të kontratës, që është 365 ditë ose 12 muaj. Në këtë mënyrë BOE jo vetëm që ka ndryshuar përmbajtjen e kësaj shtojce, por edhe nuk ka konfirmuar që oferta e tij është e vlefshme për periudhën e kërkuar 12 muaj sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit. 2. Nuk ka përcaktuar cmimin neto (total pa tvsh) që përbën vlerën totale të ofertës/kontratës. 3. Nuk ka plotësuar vlerën totale të Tvsh (në masen 20%); 4. Nuk ka përcaktuar cmimin total me tvsh që përbën vlerën totale të ofertës/kontratës. Neni 14 VKM parashikon [...]. Pika 1.1 e dokumentave të tenderit (udhëzime për operatorët ekonomikë) të miratuara nga autoriteti kontraktor, parashikon: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”. Neni 53 I VKM 914 pika 5, germa

c [...]. Referuar dispozitave të sipërcituara ofertat e paraqitura nga BOE nuk plotësojnë kriteret, kërkesat dhe udhëzimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ndaj duhet të refuzohet/skualifikohet.

II.7.1. Në datën 05.07.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 3375/1 prot., autoriteti kontraktori i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën.

II.7.2. Në datën 12.07.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 3375/4 prot., datë 24.07.2018, protokolluar me tonën në datën 24.07.2018, me objekt “Dërgim informacioni për Vendimin nr. 1252/2 prot., datë 16.07.2018, protokolluar në QSUT me nr. 3375/3, datë 18.07.2018” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k., për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. me arsyetimin se “BOE në kontratën e bashkimit nuk kanë përcaktuar elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, konkretisht numrin e rojeve me të cilët do të jetë pjesëmarrës cdo anëtar i BOE, venrojet ku do të kryhet shërbimi nga secili prej anëtarëve të BOE. Gjithashtu BOE nuk e ka pasqyruar këtë bashkim në sistemin elektronik të prokurimeve app, ku në llogarinë e kryesuesit të BOE pasqyrohen/selektohen edhe anëtarët e tjerë të BOE, konkretisht anëtari “Eurogjici Security” dhe “NSS”, kërkesë kjo e përcaktuar në udhëzimet dhe manualët për operatorët ekonomikë. Për sa më sipër oferta e BOE duhet të refuzohet/skualifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në kreun II të dokumentave të tenderit, *Udhëzime për Operatorët Ekonomikë* është e përcaktuar: “Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomik, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit”.

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9 “Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit” nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo

*anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur... Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen: a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme”.*

III.1.3. Në Kreun VIII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi*”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”.

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur:

- Dokumenti Nr.754 Rep, Nr. 361 Kol, datë 15.03.2018, me emërtimin *Akt – Marrëveshje për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë* ndërmjet shoqërisë “Toni Security” sh.p.k., shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k. dhe shoqërisë “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.), nga ku shoqëria “Toni Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 28.57 % të shërbimit (6 vendroje me 4.98 roje me tre turne), shoqëria “Eurogjici Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 23.81 % të shërbimit (5 vendroje me 4.98 roje me tre turne) dhe shoqëria “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.) merr përsipër të kryejë 47.62 % të shërbimit (10 vendroje me 4.98 roje me tre turne).
- Dokumenti *Prokurë e Posaçme* datë 15.03.2018 ku është deklaruar se shoqëria “Toni Security” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, konstaton se dokumenti *Akt – Marrëveshje për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë*, është një dokument i cili është lidhur

ndërmjet operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k., “Eurogjici Security” sh.p.k. dhe “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k., si një bashkim i përkohëshëm për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit me objekt “*Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike të Objekteve dhe Godinave, Sipërfaqeve të Gjelbërta dhe Bimësisë, të QSUT*” – *Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”. Gjithashtu, janë përcaktuar ndarja e detyrave ku shoqëria “Toni Security” sh.p.k. merr përsipër të realizojë 28.57 % të shërbimit (6 vendroje me 4.98 roje me tre turne), shoqëria “Eurogjici Security” sh.p.k. merr përsipër të realizojë 23.81 % të shërbimit (5 vendroje me 4.98 roje me tre turne) dhe shoqëria “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.) merr përsipër të realizojë 47.62 % të shërbimit (10 vendroje me 4.98 roje me tre turne), pra duke përcaktuar kështu të gjithë elementët konkretë të shërbimit që do të kryejë secili prej anëtarëve të bashkimit. Gjithashtu, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur edhe dokumenti *Prokurë e Posaçme* ku deklarohet se shoqëria “Toni Security” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi.

III.1.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., ka paraqitur ofertë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Konkretisht, ky bashkim operatorësh ka paraqitur dokumentacion në lidhje me kontratën e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme, me të gjithë elementët konkretë të nevojshëm për një procedurë prokurimi, duke dhënë detaje të rëndësishme si në lidhje me autoritetin kontraktor, objektin e procedurës si dhe elementët konkretë të domosdoshëm për këtë objekt prokurimi, duke përmbushur kriterin për paraqitjen e këtij dokumenti të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

**Public Health Sector**

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k., për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. me arsyetimin se “*nuk kanë paraqitur formularin e informacionit konfidencial*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit të publikuara në sistemin e prokurimeve elektronike pjesë përbërëse e tyre është Shtojca 4 “*Lista e informacionit konfidencial*” (Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial).

<i>Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial</i>	<i>Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale</i>	<i>Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial</i>	<i>Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial</i>


III.2.2. Në Kreun VIII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi*”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.*

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Nr.754 Rep, Nr. 361 Kol, datë 15.03.2018, me emërtimin *Akt – Marrëveshje për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë* ndërmjet shoqërisë “Toni Security” sh.p.k., shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k. dhe shoqërisë “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.), nga ku shoqëria “Toni Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 28.57 % të shërbimit, shoqëria “Eurogjici Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 23.81 % të shërbimit dhe shoqëria “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 47.62 % të shërbimit.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti *Prokurë e Posaçme* datë 15.03.2018 ku është deklaruar se shoqëria “Toni Security” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi.

III.2.4. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

III.2.5. Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., në sistemin elektronik për këtë procedurë rezulton se këta të fundit e kanë paraqitur Shtojcën 4. Operatorët ekonomik “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k. e kanë plotësuar këtë shtojcë duke cituar informacionin që kërkojnë të mbetet konfidencial, ndërsa operatori ekonomik “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. e ka paraqitur këtë shtojcë, duke mos cituar informacionin që kërkon të mbetet konfidencial.

III.2.6. Në dokumentat standarte të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, vërejmë se Shtojca 4, *“Lista e Informacionit Konfidencial”*, është vendosur si pjesë përbërëse e këtyre dokumenteve me qëllim deklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të dokumenteve të cilët ata dëshirojnë që të mos bëhen publike kundrejt operatorëve të tjerë konkurrentë. Gjithashtu, evidentohet se në këtë shtojcë është përcaktuar që është *Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik nëse është rasti*, për të shënuar informacionin që operatori ekonomik dëshiron të mbahet konfidencial.

III.2.7. Neni 25 *“Fshehtësia e Procesit”*, i LPP përcakton se: *“Pa cënuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale.*

*Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave”.*

Përmes këtij rregullimi, i cili është ndikuar sa nga praktika aq edhe nga Direktivat e BE mbi fushën, legjislatori ka dashur t’iu vijë në ndihmë ekskluzivisht operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të një procedure prokurimi, mundësia që iu krijohet atyre për të ruajtur konfidencialitetin e mënyrës së prodhimit të mallrave apo teknologjinë që përdor kompania si dhe koston e prodhimeve të mallrave, apo edhe elementë të tjerë që mund të konsiderohen “sekrete tregtare”, nuk ka asnjë lidhje dhe nuk cënon asnjë interes të autoritetit kontraktor, përkundrazi, lehtëson dhe nxit pjesëmarrjen e sa më shumë pjesëmarrësve, duke rritur kështu konkurrencën, me rrjedhojë potencialisht të lartë uljen e çmimit të ofertave.

Në rastin konkret, secili nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë të mësipërm kanë paraqitur listën me informacionin që kërkojnë t’u mbetet konfidencial, operatorët ekonomik “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k. e kanë plotësuar këtë shtojcë duke cituar informacionin që kërkojnë të mbetet konfidencial, ndërsa operatori ekonomik “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. megjithëse nuk ka cituar informacionin të cilin kërkon të mbetet konfidencial, e ka paraqitur këtë shtojcë dhe e ka nënshkruar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, edhe në rast se një operator ekonomik nuk e ka paraqitur shtojcën 4, në thelb, i vetmi subjekt i cënuar është vetë operatori ekonomik i pakujdesshëm, i cili, *a priori*, do ta ketë të vështirë të mbrojë informacionin (teknik, financiar apo ligjor) e paraqitur në këtë procedurë prokurimi por, nga ana tjetër, është në kundërshtim me *ratio* të legjislacionit mbi prokurimin publik që kjo mungesë të çojë në skualifikimin automatik të tij, duke qenë se nuk ka asnjë ndikim si në ofertën e tij edhe në qëllimin e autoritetit kontraktor, i cili është garantimi i ekzekutimit me sukses të kontratës së shërbimit me sa më pak shpenzime.

Referuar arsytimit të mësipërm, gjykojmë se pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k. nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k., për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. me arsyetimin se *“BOE “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. nuk kanë paraqitur certifikatat e punonjësve të shërbimit brenda afatit 4 vjeçar të vlefshmërisë, për rrjedhojë certifikatat e paraqitura sipas përcaktimeve të dispozitave të*

*sipërcituara janë të pavlefshme dhe nuk plotësojnë kriterin e sipërcituar” dhe pretendimin se “Numri i certifikatave të punonjesve të shërbimit të lëshuara të cilat plotësojnë kushtin e vlefshmërisë së tyre (brenda afatit 4 vjetar) paraqitura nga BOE në ofertë nuk korrespondon me përqindjen e pjesëmarrjes në shërbim të cdo anëtarit të BOE. Ky fakt provohet nga certifikatat e punonjësve të shërbimit të paraqitura në ofertë, vertetimet e performancës dhe lista emerore bashkëngjitur tyre lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë dhe kontratat/aktmarrëveshja e BOE” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7, Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri:

*“- Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën \_63\_ punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë; përfshire titullarin dhe drejtuesin teknik të shoqërisë - Vertetim i lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore , i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emerore të punonjesve të shërbimit të certifikuar dhe vlefshmerinë e këtyre certifikatave – datën e certifikimit ( datën e lëshimit) , si edhe afatin e vlefshmerisë së kësaj certifikate.”*

III.3.2. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.*

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., rezulton se, ky i fundit ka paraqitur dokumentin Nr.754 Rep, Nr. 361 Kol, datë 15.03.2018, me emërtimin *Akt – Marrëveshje për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë* ndërmjet shoqërisë “Toni Security” sh.p.k., shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k. dhe shoqërisë “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k., nga ku shoqëria “Toni Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 28.57 % të shërbimit (6 vendroje me 4.98 roje me tre turne), shoqëria “Eurogjici Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 23.81 % të shërbimit (5 vendroje me 4.98 roje me tre turne) dhe shoqëria “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.) merr përsipër të kryejë 47.62 % të shërbimit (10 vendroje me 4.98 roje me tre turne). Gjithashtu ka dorëzuar edhe dokumentin *Prokurë e Posaçme* datë 15.03.2018 ku është deklaruar se shoqëria “Toni Security” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi.



III.3.4. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

III.3.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

Operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k.

- Shkresë nr. 259/6 Prot., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku vërtetohen të dhëna në lidhje me shoqërinë “Toni Security” sh.p.k., për performancën e veprimtarisë së saj, për periudhën nga data 01.01.2017 e në vijim.
- Çertifikata të punonjësve të shërbimit për ruajtjen dhe sigurinë fizike, lëshuar nga DVP Tiranë.

Operatori ekonomik “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.

- Shkresë nr. 649/4 Prot., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku vërtetohen të dhëna në lidhje me shoqërinë “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k., për performancën e veprimtarisë së saj, për periudhën nga data 01.01.2017 e në vijim.
- Çertifikata të punonjësve të shërbimit për ruajtjen dhe sigurinë fizike, lëshuar nga DVP Tiranë.

Operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k.

- Shkresë nr. 722/5 Prot., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku vërtetohen të dhëna në lidhje me shoqërinë “Eurogjici Security” sh.p.k., për performancën e veprimtarisë së saj, për periudhën nga data 01.01.2017 e në vijim.
- Çertifikata të punonjësve të shërbimit për ruajtjen dhe sigurinë fizike, lëshuar nga DVP Tiranë.

III.3.6. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.3.7. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekti i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*

*c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.3.8. Neni 5 i Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikon shprehimisht se:

1. *Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*

2. *Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut.*

3. *Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së.*

4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësën e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim.

5. Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësën e shërbimit.

III.3.9. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.

III.3.10. Në rekomandimin e përbashkët ndërmjet Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike”, i datës 20.12.2017, publikuar në faqen zyrtare të KPP, në pikën 2, paragrafi 7, është parashikuar shprehimisht: “Në lidhje me hartimin e kriterit për paraqitjen e certifikatave të punonjësve të shërbimit, në kushtet kur, procesi i ricertifikimit të punonjësve të shërbimit nuk ka përfunduar ende dhe është në proces për një afat të pacaktuar, kjo sipas informacionit të dhënë nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, autoritetet kontraktore rekomandohen si më poshtë vijon:

*Në rastet kur, në dokumentat e tenderit do të kërkohet paraqitja e certifikatave të punonjësve të shërbimit, së bashku me këtë kriter rekomandojmë që, të kërkohet edhe paraqitja e një vërtetimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar, dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave, datën e certifikimit (datën e lëshimit), si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate.”*

III.3.11. Në korrespondencën e Komisionit të Prokurimit Publik me Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në lidhje me vlefshmërinë e certifikatave, kjo e fundit citon se: “Cilësimi i (vlefshëm) në vërtetimet e performancave për punonjës të certifikuar të cilëve sipas ligjit aktual i ka përfunduar afati 4 vjeçar, është bërë për shkak të vakumit ligjor të krijuar nga anulimi i udhëzimit 308, datë 22.05.2017 “Për funksionin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-ve” si dhe akteve ligjore e nënligjore për zbatimin e ligjit 75/2014 “Për

*shërbimin privat të sigurisë fizike”. Mungesa e bazës ligjore pezulloi përkohësisht procesin e çertifikimit të aplikantëve për shpsf-t, dhe qëllimi i cilësimit i “vlefshëm” ishte shmangia nga penaliteti i punonjësve të cilët sipas ligjit aktual paisen me çertifikatat me afat 4 –vjeçar.*

*Bazuar në nenin 5 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, dhe Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, afati i vlefshmërisë së çertifikatave të punonjësve të shërbimit, shpsf, është 4 vjeçar nga momenti i çertifikimit të tyre”.*

III.3.12. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “Flena-RB” sh.p.k. dhe “Myrto Security” sh.p.k., mbi kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., KPP konstaton se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomik duhet të paraqesin çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 63 punonjës shërbimi, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë. Vlen të theksojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marrë përsipër. Në rastin konkret operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k., si anëtar i bashkimit ka marrë përsipër 28.57 % të kryerjes së shërbimit, operatori ekonomik “N.S.S (Ndreu Security Service) sh.p.k. si anëtar i bashkimit ka marrë përsipër 47.62 % të kryerjes së shërbimit, ndërsa operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. si anëtar i bashkimit ka marrë përsipër 23.81 % të kryerjes së shërbimit. Rrjedhimisht edhe paraqitja e numrit të çertifikatave për punonjësit e shërbimit, nga këta operatorë ekonomikë, si pjesëtarë të bashkimit të përkohshëm të shoqërive, do të bëhet në përputhje me përqindjen që secili ka marrë përsipër, sipas kontratës së bashkëpunimit.

Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., konstatojmë se ky i fundit ka paraqitur një numër më të madh se 63 çertifikata të punonjësve të shërbimit për ruajtjen dhe sigurinë fizike, lëshuar nga DVP Tiranë, brenda afatit 4-vjeçar të vlefshmërisë të parashikuar në nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Pra, secili nga anëtarët e këtij bashkimi të përkohshëm të shoqërive ka dorëzuar një numër të konsiderueshëm çertifikatash të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar të punonjësve të shërbimit për ruajtjen dhe sigurinë fizike, në përputhje me përqindjen që kanë marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit, duke plotësuar kështu kërkesën e autoritetit kontraktor për 63 çertifikata të punonjësve të shërbimit të ruajtjes. Komisioni vëren se në asnjë dispozitë ligjore apo akt nënligjor nuk parashikohet se çertifikatat për punonjësit e shërbimit janë me afat të pacaktuar, përkundrazi për afatin e vlefshmërisë së tyre, pika 5 e nenit 5 të ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, parashikon se çertifikatat lëshohen për një afat 4-vjeçar me të drejtë ripërtëritje. Edhe vetë Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, me tagrat e organit kompetent dhe përgjegjës për çertifikimin e punonjësve të shërbimit të shoqërive shpsf, sqaron në kthimin e përgjigjes drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet shkresës me nr. 4039/1 prot., datë 27.04.2018, se afati i vlefshmërisë së çertifikatave të punonjësve të shërbimit shpsf, është 4 vjeçar, nga momenti i çertifikimit. APP dhe KPP rekomandojnë se, në rastet kur në dokumentat e tenderit do të kërkohet paraqitja e çertifikatave të punonjësve të shërbimit, së bashku me këtë kriter, të kërkohet edhe paraqitja e një vërtetimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, i cili duhet të

përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar, dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave, datën e certifikimit (datën e lëshimit), si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shkresën nr. 259/6 Prot., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku vërtetohen të dhëna në lidhje me shoqërinë “Toni Security” sh.p.k., për performancën e veprimtarisë së saj, për periudhën nga data 01.01.2017 e në vijim, shkresën nr. 649/4 Prot., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku vërtetohen të dhëna në lidhje me shoqërinë “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k., për performancën e veprimtarisë së saj, për periudhën nga data 01.01.2017 e në vijim, shkresën nr. 722/5 Prot., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku vërtetohen të dhëna në lidhje me shoqërinë “Eurogjici Security” sh.p.k., për performancën e veprimtarisë së saj, për periudhën nga data 01.01.2017 e në vijimku, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë nuk ka përcaktuar afat vlefshmërie të certifikatave të punonjësve të shërbimit të listuar në këtë shkresë (vërtetim), por ka pasqyruar datën e lëshimit të certifikatave, nga ku vërtetohet se secili nga operatorët ekonomikë pjesë të bashkimit të përkohëshëm të shoqërive, disponojnë më shumë punonjës shërbim, të pajisur me certifikata të vlefshme, brenda afatit 4 vjeçar, se sa përqindja që kanë marrë përsipër për këtë shërbim në kontratën e bashkëpunimit.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., ka përmbushur kriterin e vendosuar nga autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pasi ka paraqitur më shumë se 63 certifikata të vlefshme për punonjësit e shërbimit, sic kërkohet nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k. për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k., për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. me arsyetimin se “*Sic rezulton nga Vërtetimet e performancës lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë të paraqitura në ofertë, anëtarët e BOE kanë marrë masa administrative në emer të operatorit ekonomik (subjektit), ndaj për mospërmbushje të këtij kriteri, oferta e BOE duhet të refuzohet/skualifikohet*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “*Kapaciteti teknik*”, pika 6, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

“6. *Operatori ekonomik duhet te kete qendër kontrolli funksionale të miratuar nga Policia e Shtetit si :*

a. *jo me pak se 63 punonjes sherbimi (me certifikatat perkatese dhe listen emerore )*

b. *salle operative (drejtimi) dhe adresen perkatese te saj*

c. *Nuk ka mase administrative gjate vitit te fundit*

\* *Per sa me lart te provohen me paraqitjen e vertetimit te leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut Tirane.”*

III.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Nr.754 Rep, Nr. 361 Kol, datë 15.03.2018, me emërtimin *Akt – Marrëveshje për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë* ndërmjet shoqërisë “Toni Security” sh.p.k., shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k. dhe shoqërisë “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.), nga ku shoqëria “Toni Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 28.57 % të shërbimit (6 vendroje me 4.98 roje me tre turne), shoqëria “Eurogjici Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 23.81 % të shërbimit (5 vendroje me 4.98 roje me tre turne) dhe shoqëria “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.) merr përsipër të kryejë 47.62 % të shërbimit (10 vendroje me 4.98 roje me tre turne).

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti *Prokurë e Posaçme* datë 15.03.2018 ku është deklaruar se shoqëria “Toni Security” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi.

III.4.3. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

III.4.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se secili nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, kanë paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresë nr. 259/6 Prot., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku vërtetohen të dhëna në lidhje me shoqërinë “Toni Security” sh.p.k., për performancën e veprimtarisë së saj, për periudhën nga data 01.01.2017 e në vijim.
- Shkresë nr. 649/4 Prot., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku vërtetohen të dhëna në lidhje me shoqërinë “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k., për performancën e veprimtarisë së saj, për periudhën nga data 01.01.2017 e në vijim.
- Shkresë nr. 722/5 Prot., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku vërtetohen të dhëna në lidhje me shoqërinë “Eurogjici Security” sh.p.k., për performancën e veprimtarisë së saj, për periudhën nga data 01.01.2017 e në vijim.

III.4.5. Në Kreun VIII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi*”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.*

III.4.6. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.4.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.8. Sa më sipër, nga shqyrtimi i pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, kërkesës së autoritetit kontraktor si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik nuk duhet të ketë masë administrative gjatë vitit të fundit, ndërkohë që secili nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor kanë paraqitur vërtetimet e performances për secilin nga operatorët ekonomike, të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në të cilat nuk konstatohet që në emër të shoqërive “Toni Security” sh.p.k., “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k., të jetë dhënë masë administrative gjatë vitit të fundit.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k., për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. me arsyetimin se *“Kontratat e ngjashme të realizuara nga 3 anëtarët e BOE të paraqitura ne ofertë nuk janë brenda periudhës 16.03.2015 – 16.03.2018, ndaj për këtë mospërmbushje, BOE duhet të refuzohet/skualifikohet”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentat e tenderit shtojca 7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 1, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

“Shërbime të meparshme te ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit te marra se bashku, ne nje vlerë sa 40 % te fondit limit.

- Kur shërbimi i ngjashëm është i realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e realizimit e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate. ose
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

III.5.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Nr.754 Rep, Nr. 361 Kol, datë 15.03.2018, me emërtimin Akt – Marrëveshje për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë ndërmjet shoqërisë “Toni Security” sh.p.k., shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k. dhe shoqërisë “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k., nga ku shoqëria “Toni Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 28.57 % të shërbimit (6 vendroje me 4.98 roje me tre turne), shoqëria “Eurogjici Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 23.81 % të shërbimit (5 vendroje me 4.98 roje me tre turne) dhe shoqëria “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.) merr përsipër të kryejë 47.62 % të shërbimit (10 vendroje me 4.98 roje me tre turne).

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti *Prokurë e Posaçme* datë 15.03.2018 ku është deklaruar se shoqëria “Toni Security” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi.

III.5.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k., shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k. dhe shoqërisë “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.), konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor:

Operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k. ka paraqitur kontratat e mëposhtme:

- Kontratë me objekt “Shërbim roje civile për qarkun e Durrësit” me nr. Prot 765/38 të datës 18.08.2015, me vlerë 1.330.917 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor Universiteti Bujqësor i Tiranës.
  - o Formular vlerësimi
- Kontratë me objekt “Loti 1-Shërbim roje civile për qarkun e Tiranës” me nr. Prot 765/36, datë 18.08.2015 me vlerë 4.980.130 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor Universiteti Bujqësor i Tiranës;
  - o Formular vlerësimi
- Kontratë me objekt “Ruajtja e Sigurisë Fizike të Universitetit Politeknik të Tiranës” me nr. Prot 19/22, datë 25.01.2016 me vlerë 38.063.279 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor Universitetit Politeknik të Tiranës;
  - o Formular vlerësimi
- Kontratë me objekt “Shërbim privat i sigurisë fizike të UT Loti 1” me nr. Prot 766/6, datë 24.02.2017 me vlerë 4.682.281,33 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor Universitetit i Tiranës;
- Kontratë me objekt “Shërbim privat i sigurisë fizike të UT Loti 1” me nr. Prot 3949/58, datë 04.07.2017 me vlerë 35.473.127 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor Universitetit i Tiranës;
  - o Formular vlerësimi

Operatori ekonomik “NSS (Ndreu Security Services)” sh.p.k. ka paraqitur kontratat e mëposhtme:

- Kontratë me objekt “Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSHEE sh.a., Rajoni Qendër” me nr. Prot 4477/9 të datës 04.03.2015, me vlerë 19.834.008 lekë pa tvsh, me autoritet kontraktor OSHEE sh.a.
  - o Formular vlerësimi
- Kontratë me objekt “Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Tiranë” me nr. Prot 4294/1 të datës 05.06.2015, me vlerë 14.751.852 lekë pa tvsh, me autoritet kontraktor OSHEE sh.a.
  - o Formular vlerësimi
- Kontratë me objekt “Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Tiranë” me nr. Prot 6489/3 të datës 05.05.2015, me vlerë 14.751.852 lekë pa tvsh, me autoritet kontraktor OSHEE sh.a.;
  - o Formular vlerësimi
- Kontratë me objekt “Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Tiranë” me nr. Prot 9025/1 të datës 07.12.2015, me vlerë 17.767.865 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor OSHEE sh.a;
- Kontratë me objekt “Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Tiranë” me nr. Prot 2052/9 të datës 08.03.2016, me vlerë 15.275.736 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor OSHEE sh.a;
- Kontratë me objekt “Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Tiranë” me nr. Prot 3838/11 të datës 09.05.2016, me vlerë 21.479.288,4 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor OSHEE sh.a;
- Kontratë me objekt “Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Tiranë” me nr. Prot 6433/12 të datës 09.08.2016, me vlerë 21.479.288,4 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor OSHEE sh.a;
  - o Formular vlerësimi për të katërt kontratat e mësipërme
- Kontratë me objekt “Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Tiranë” me nr. Prot 9171/11 të datës 09.11.2016, me vlerë 21.479.288,4 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor OSHEE sh.a;
- Kontratë me objekt “Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Tiranë” me nr. Prot 913/13 të datës 09.02.2017, me vlerë 21.142.950,78 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor OSHEE sh.a;
- Kontratë me objekt “Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Tiranë” me nr. Prot 3881/15 të datës 10.05.2017, me vlerë 21.142.950,78 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor OSHEE sh.a;
- Kontratë me objekt “Shërbim Sigurie për Ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Tiranë” me nr. Prot 6657/19 të datës 10.08.2017, me vlerë 22.938.828,87 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor OSHEE sh.a;
  - o Formular vlerësimi për të katërt kontratat e mësipërme

Operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. ka paraqitur kontratat e mëposhtme:

- Kontratë me objekt “Shërbim privat i sigurisë fizike të UT” me nr. Prot 3278/16 të datës 02.03.2015, me vlerë 43.514.179 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor Universiteti i Tiranës.
  - o Formular vlerësimi



- Kontratë me objekt “Shërbim privat i sigurisë fizike të UT” me nr. Prot 5200/1 të datës 30.12.2015, me vlerë 6.258.170 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor Universiteti i Tiranës.
  - o Formular vlerësimi
- Kontratë me objekt “Shërbim privat i sigurisë fizike të UT Loti 1” me nr. Prot 3656/5 të datës 22.06.2016, me vlerë 37.575.051 lekë me tvsh, me autoritet kontraktor Universiteti i Tiranës.;
  - o Formular vlerësimi

III.5.4. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

*Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.5.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.5.6. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.5.7. Neni 28, pika 3 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

*Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”*

III.5.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.5.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit dhe konkretisht secili nga operatorët ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., kanë dorëzuar dokumentacionin sipas kërkesave të autoritetit kontraktor të përcaktuar në dokumentat e tenderit, duke paraqitur kontrata të ngjashme të zhvilluara brenda afatit të përcaktuar në dokumentat e tenderit, si dhe duke tejkaluar vlerën e kontratave të ngjashme të paraqitura, në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

III.5.10. Sa më sipër, KPP gjykon se, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Sa më sipër, KPP, konstaton se, me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 7, pika 3.3.1. “Për Kapaciteti teknik” të dokumentave të tenderit për sa i përket eksperiencës së ngjashme. Në këto kushte, KPP gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për sa i përket kontratave të ngjashme.

Rrjedhimisht sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k., për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. me arsyetimin se *“Anëtarët e BOE nuk e kanë plotësuar këtë kriter sipas përqindjes së pjesëmarrjes në BOE. Pra radio ndërlidhjet që ka paraqitur nuk korrespondojnë me pjesëmarrjen në shërbim të përcaktuar në kontratë, ndaj oferta e tyre duhet të refuzohet/skualifikohet”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 8, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

Subjektet e SHPSF-së duhet te provojnë se, disponojnë mjete dhe pajisje teknike për të përmbushur objektin e kësaj kontrate si më poshtë:

Nr.	Emertimi i pajisjeve	Sasia	Disponibiliteti
1.	Radio nderlidhje	21 cope	ne pronesi ose me qera
2.	Automjete	2 cope	ne pronesi ose me qera

- i. Për pajisjet, nëse janë në pronësi, duhet të paraqitet fatura tatimore e shitjes.
- ii. Për pajisjen, nëse është me qera, duhet të paraqitet kontrata e qirasë dhe fatura tatimore e shitjes.
- iii. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (certifikata e pronësise, leje qarkullimi, police sigurimi dhe kontrolli teknik)
- iv. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qirase si dhe dokumenti që vërteton regjistrimin (certifikata e pronësise, leje qarkullimi, police sigurimi dhe kontrolli teknik).

III.6.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Nr.754 Rep, Nr. 361 Kol, datë 15.03.2018, me emërtimin *Akt – Marrëveshje për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë* ndërmjet shoqërisë “Toni Security” sh.p.k., shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k. dhe shoqërisë “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.), nga ku shoqëria “Toni Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 28.57 % të shërbimit (6 vendroje me 4.98 roje me tre turne), shoqëria “Eurogjici Security” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 23.81 % të shërbimit (5 vendroje me 4.98 roje me tre turne) dhe shoqëria “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.) merr përsipër të kryejë 47.62 % të shërbimit (10 vendroje me 4.98 roje me tre turne).

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti *Prokurë e Posaçme* datë 15.03.2018 ku është deklaruar se shoqëria “Toni Security” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi.

III.6.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

Operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k.

- Faturë tatimore nr. 9558, nr. 3558, nr. 9545, nr. 9537, nr. 9545, nr. 6923, nr. 9534, nr. 9537, nr. 9157.

Operatori ekonomik “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k.

- Faturë tatimore nr. 1242, nr. 1072

Operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k.

- Faturë tatimore nr. 9176, nr. 9136, nr. 3557, nr. 6924, nr. 9177, nr. 9174, nr. 9175, nr. 9136, nr. 9142, nr. 3557, nr.9176

III.6.4. Në Kreun VIII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi*”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”*, ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.6.5. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.6.6. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 28, pika 5, gërmat a-ç, parashikohet si më poshtë: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

III.6.7. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

III.6.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

III.6.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të publikuara nga autoritetit kontraktor për procedurën objekt ankimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duhet të plotësojnë kërkesën për

disponimin e 21 ndërlidhje vërtetuar kjo me faturë tatimore blerje. Në rastin konkret, duke qenë se operatorët ekonomikë “Toni Security” sh.p.k., “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k. kanë marrë pjesë në këtë procedurë prokurimit si një bashkim operatorësh, referuar rregullave të prokurimit publik, secili nga këto anëtarë të bashkimit duhet të plotësojë kriterin e vendosur në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në këtë bashkim, referuar kontratës së bashkëpunimit. Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti në lidhje me disponimin e radio marrëse-dhënëse, KPP konstaton se, secili nga operatorët ekonomikë pjesëtarë të bashkimit të përkohëshëm të shoqërive kanë paraqitur fatura tatimore me anë të të cilave vërtetojnë se disponojnë një numër më të lartë radio ndërlidhjeje në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në kontratën e bashkëpunimit, duke plotësuar kështu kërkesën e autoritetit kontraktor të vendosur në dokumentat e tenderit për 21 radio ndërlidhje. Në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k.ka përmbushur kërkesën e autoritetit në lidhje me disponimin e radiove marrëse dhënëse të përcaktuar në Shtojcën 7, të dokumentave të tenderit.

Rrjedhisht, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k. nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k., për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. me arsyetimin se *“...BOE nuk ka plotësuar me cmime zerat e prevetivit për 1 vëndroje në muaj, si më poshtë: 1. Shpenzime për page baze: për 1 vëndroje në ditë; 2. Shtese mbi page për turnin II: për 1 vëndroje në ditë; 3. Shtese mbi page për turnin III: për 1 vëndroje në ditë; 4. Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%: për 1 vëndroje në ditë”, si dhe pretendimin se “BOE nuk e ka paraqitur formularin e ofertës sipas kërkesave të sipërcituara pasi: Nuk e ka përcaktuar vlerën totale të ofertës pa Tvsh. Nuk e ka përcaktuar vlerën totale të ofertës me Tvsh. Gjithashtu në tabelën ku llogaritet vlera e kontratës: Nuk ka përcaktuar afatin e përlllogaritur në ditë të kontratës, që është 365 ditë ose 12 muaj. Në këtë mënyrë BOE jo vetëm që ka ndryshuar përmbajtjen e kësaj shtojce, por edhe nuk ka konfirmuar që oferta e tij është e vlefshme për periudhën e kërkuar 12 muaj sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit. Nuk ka përcaktuar cmimin neto (total pa tvsh) që përbën vlerën totale të ofertës/kontratës. Nuk ka plotësuar vlerën totale të Tvsh (në masën 20%); Nuk ka përcaktuar cmimin total me tvsh që përbën vlerën totale të ofertës/kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.7.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.7.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.7.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.7.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomikë – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përlogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.7.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përlllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimes duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.7.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.7.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t’i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.7.8. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 1 Formulari i Ofertës nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

#### *FORMULARI I OFERTËS*

*Emri i Ofertuesit* \_\_\_\_\_

*Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

\* \* \*

*Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]*

*Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]*

*Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se*

\* \* \*



Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

3. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
4. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH
- 5.

1	2	3	4	5	
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njësi /dite	Afati i perlllogarit ur ne dite
1.	Shërbimi i ruajtjes se godines se _____ per 1 vend roje me 3 turne	dite	1		
		Çmimi Neto			
		TVSH (%)			
		Çmimi Total			

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Sqarime:

3. Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per shërbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.
4. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- *Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".*
- *Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vëndroje me tre turne të llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjës/muaj: 174 ore). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).*
- *Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore,) rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.*
- *Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )*

Në shtojcën 7, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 5, është përcaktuar kriteri: "Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur. (Shih Shtojca 1 - Sqarime)."

Ndërsa në shtojcën 11 "Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit", autoriteti kontraktor ka përcaktuar: *Shërbimi që kërkohet: Objekti: "Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike të Objekteve dhe Godinave, Sipërfaqeve të Gjelbërta dhe Bimësisë, të QSUT" – Marrveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.*

*Afatet e ekzekutimit: 12 muaj ( i parashikuar)*

*Vendndodhja e shërbimit: Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë*

<i>Numri i Vëndrojeve</i>	<i>Numri i turneve</i>	<i>Numri i rojeve të nevojshme</i>	<i>Afati i levrimit</i>
21	3	4.98	12 muaj <i>Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.</i>

III.7.9. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ju ka kërkuar të gjithë ofertuesve që të paraqesin ofertën e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore si edhe që gjatë këtyre përlloraritjeve të merren parasysh të gjitha parashikimet ligjore në lidhje me pagën bazë minimale ligjore, shtesat për turnin e dytë e të tretë, kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Shërbimi i kërkuar është për 21 vëndroje me shërbim 24 orë pa ndërprerje për një periudhë për 12 muaj. Gjithashtu, autoriteti kontraktor në kriteret për kualifikim ka përcaktuar që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur. Në lidhje me ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Toni Security" sh.p.k. & "N.S.S (Ndreu Security Services)" sh.p.k. & "Eurogjici-Security" sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka

kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesmarrës të plotësojnë analizën e kostos ditore të kryerjes së shërbimit (preventivin) në përputhje me tabelën e mëipërme ku vërehet se është parashikuar të përllogaritet në një rën prej kolonave të saj vlera në lekë për një roje në ditë dhe në kolonën tjetër vlera në lekë për një vendroje me tre turne në ditë. Nga shqyrtimi i analizës së kostos (preventivit) të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, ky i fundit ka plotësuar të gjitha zërat e shpenzimeve për një roje në dite dhe për një vendroje me tre turne në ditë, pra ka plotësuar të dyja kolonat e tabelës së përcaktuar në dokumentat e tenderit për analizën se kostos. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. ka paraqitur të plotësuar analizën e kostos (preventivin) sipas përcaktimeve në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur nga secili prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin konkret bashkimi i operatorëve ekonomikë ka plotësuar elementët bazë të ofertës sipas zërave të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.7.10. Akoma më tej, për sa i përket pretendimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. në formularin e ofertës *nuk ka përcaktuar vlerën totale të ofertës me pa tvsh dhe vlerën totale të ofertës me tvsh si dhe nuk ka përllogaritur afatin në ditë të kontratës*, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i ofertës së dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k., vëren se ky i fundit ka paraqitur ofertën e tij sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, gjithashtu konstatohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, në analizën e kostos ka kryer llogaritjet duke pasqyruar vlerën totale të ofertës së tij referuar kohëzgjatjes së shërbimit dhe numrit të vendrojëve. Për me tepër edhe vetë autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave në Sistemin e Prokurimit Elektronik e ka renditur këtë bashkim operatorësh ekonomikë sipas vlerës totale që ky i fundit ka paraqitur në ofertën e tij.

Sa më sipër pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. & “N.S.S (Ndreu Security Services)” sh.p.k. & “Eurogjici-Security” sh.p.k. nuk qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë,

## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Flena RB” sh.p.k. & “Myrto Security” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-40008-01-10-2018, me objekt “Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike të Objekteve dhe Godinave, Sipërfaqeve të Gjelbërta dhe Bimësisë, të QSUT” – Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 69.005.544,30 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 16.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
  4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1252 Protokolli**

**Datë 12.07.2018**

